



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 159/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.05.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Luan Sopaj” p.f. & “Servis – Auto 2000” sh.p.k në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-50456-02-13-2020, me objekt: “*Mirëmbajtje dhe Shërbim i Riparimit të Automjeteve dhe Makinerive*”, me fond limit 9,747,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.03.2020, nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.

Ankimues: BOE “Luan Sopaj” p.f. & “Servis – Auto 2000” sh.p.k.
Adresa: Lagjia e Re, Rruga e Prizrenit, Kukës.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kukës
Adresa: Sheshi “Skenderbej”, lagjia nr.5, Kukës.

Baza Ligjore: *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga BOE ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. BOE ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka pranuar pjesërisht atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. BOE ankimues nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14.02.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-50456-02-13-2020, me objekt: “*Mirëmbajtje dhe Shërbim i Riparimit të Automjeteve dhe Makinerive*”, me fond limit 9,747,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.03.2020, nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.

II.2. Në datën 19.03.2020, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.3. Referuar materialeve të administruara, informacionit të autoritetit kontraktor dhe parashtrimeve me shkrim të BOE ankimues “Luan Sopaj” p.f. & “Servis – Auto 2000” sh.p.k., KPP vëren se ky i fundit në datën 24.03.2020, ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor me anë të të cilit kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.4. Referuar materialeve të administruara, parashtrimeve me shkrim të BOE ankimues, si edhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se është dorëzuar gjithashtu edhe akti administrativ nr.2074prot., datë 03.04.2020, trajtim i ankesës së autoritetit kontraktor, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ngritur pranë këtij të fundit, nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.5. Në datën 14.04.2020, BOE ankimues “Luan Sopaj” p.f. & “Servis – Auto 2000” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Në datën 14.02.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit *Procedurë e hapur*”, me nr. REF-50456-02-13-2020, me objekt: *“Mirëmbajtje dhe Shërbim i Riparimit të Automjeteve dhe Makinerive”*, me fond limit 9,747,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.03.2020, nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.

III.1.1. Në datën 19.03.2020, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

III.1.2. Referuar materialeve të administruara, informacionit të autoritetit kontraktor dhe parashtrimeve me shkrim të BOE ankimues “Luan Sopaj” p.f. & “Servis – Auto 2000” sh.p.k., KPP vëren se ky i fundit në datën 24.03.2020, ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor me anë të të cilit kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.3. Referuar materialeve të administruara, parashtrimeve me shkrim të BOE ankimues, si edhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se është dorëzuar gjithashtu edhe akti administrativ nr.2074prot., datë 03.04.2020, trajtim i ankesës së autoritetit kontraktor, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, ngritur pranë këtij të fundit, nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

III.1.4. Në datën 14.04.2020, BOE ankimues “Luan Sopaj” p.f. & “Servis – Auto 2000” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: *“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” “Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes

së ankesës, të cilin duhet t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, konstatohet se ankesa e BOE ankimes “Luan Sopaj” p.f. & “Servis – Auto 2000” sh.p.k., është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në datën 24.03.2020, referuar aktit të trajtimit të ankesës nr.2074prot., datë 03.04.2020. Gjithashtu, konstatohet se autoriteti kontraktor nuk ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën brenda afatit të parashikuar në nenin 63, pika 5 të LPP-së. Referuar, ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik të ndryshuar”, parashikohet se ankimi administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik dorëzohet me shkrim brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik nis ditën e nesërme të punës pas përfundimit të afatit të parashikuar nga neni 63 pika 5 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se BOE ankimes ka ezuaruar ankim administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 2 të L.P.P.-së. Me marrjen e ankesës në dorëzim nga autoriteti kontraktor, ky i fundit ka detyrimin ligjor të shqyrtojë ankesën dhe të marrë një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës. Mos respektimi i afatit të sipërcituar nga ana e autoritetit kontraktor nuk çënon në asnjë rast pozitën e operatorëve ekonomikë ankimes, pasi kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar edhe momentin procedural të nisjes së llogaritjes së afateve ligjore për ankim administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në rastet kur autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 5 të LPP-së. Sa më sipër, K.P.P konstaton se ankimi i dorëzuar pranë saj, nga operatori ekonomik ankimes më datë 14.04.2020 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga *lex specialis*, pasi referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë KPP nis nga dita e nesërme e punës kur operatori ekonomik ankimes duhet të ishte njoftuar nga autoriteti kontraktor mbi shqyrtimin e ankesës nga ky i fundit dhe përfundon ditën e dhjetë. Në rastin konkret, afati maksimal i paraqitjes së ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga ana e BOE ankimes është datë 09.04.2020, për këtë arsye, ankesa e paraqitur prej këtij të fundit disa ditë më vonë është pas përfundimit të afatit duke mos u legjitimuar *ratione temporis* në dorëzimin e ankesës pranë K.P.P.

III.1.7. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankesa e dorëzuar nga BOE ankimes “Luan Sopaj” p.f. & “Servis – Auto 2000” sh.p.k., nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga

“elementet e domosdoshëm të ankesës”, ndaj dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimimit. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.1.8. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE ankimues “Luan Sopaj” p.f. & “Servis – Auto 2000” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-50456-02-13-2020, me objekt: “Mirëmbajtje dhe Shërbim i Riparimit të Automjeteve dhe Makinerive”, me fond limit 9,747,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.03.2020, nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 341 Protokoli, Datë 14.04.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha